



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES S.B. a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

**RREGULLORE
PËR MBROJTJEN NGA RREZATIMET JONIZUESE DHE JOJONIZUESE
NË KEK**

Në bazë të parimeve të Ligjit nr.03/L-104 të Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi Jo-jonizues, Jonizues dhe Sigurinë Nukleare i miratuar me datën 11. Shkurt 2010, si dhe nenit 4 të Rregullores për Shëndetin dhe Mjedisin e punës në KEK, nr. 1316, Bordi i Drejtorëve të KEK-ut, në seancën e vet të mbajtur me datën 29 janar 2015, aprovoi këtë Rregullore:

Neni 1.

Kjo rregullore përcakton kushtet e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe jo jonizuese për të gjitha veprimet që kryhen me elemente radioaktive me pajisje në proceset tekniko teknologjike në KEK, për të mbrojtur punonjësit e ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve të mundshme .

Neni 2.

Divizionet dhe Departamentet e KEK-ut janë të obliguara të mbajnë evidencë të saktë të instalimeve, mjeteve dhe pajisjeve me radioaktivitet jonizues në stabilimentet e procesit teknologjik.

Neni 3.

Menaxherët e Departamenteve përcaktojnë personin përgjegjës dhe ndërlidhës me palët profesionale të sigurisë në punë, mbrojtjes së ambientit si dhe me inspektionet e autoritetit shtetëror të fushës së mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe jo jonizuese.

Neni 4.

Hapësirat me rrezatim jonizues dhe pajisjet me radioaktivitet jonizues duhet të jenë të shënuara me shenja-tabela të vërejtjeve adekuate.

Neni 5.

Punëdhënësi përcakton personelin punues që kryen punë në hapësirat ku janë të instaluar resurse radioaktive (jonizuese) dhe obligon atë personel për bartjen e dozimetrave (pajisje për matjen e shkallës së rrezatimit jonizues në ambientin e punës).

Neni 6.

Punëdhënësi ka obligim që dozimetrat t'i dërgojë në lexim Institucioneve përkatëse që janë të licencuar (Certifikuar) për mbrojtjen në Rrezatimi jonizues dhe jojonizues.

Neni 7.

Në rastet e paraqitjes së shkallës mbi-kufitare të lejuar të rrezatimit jonizues, të merren masa për kthimin në gjendjen e lejuar. Për këtë duhet angazhuar ekipet profesionale për matje të radioaktivitetit.

Neni 8.

Kontrollimi sistematik (specialistik) mjekësor për personelin që kryen punë në proceset tekniko teknologjike e që ekziston rreziku i ekspozimit me rreze jo-jonizuese apo jonizuese – të deshifruara nga dozimetëri bëhet në çdo 6 muaj në Institucione mjekësore të specializuara.

Neni 9.

Në rastet e të veçanta të ndodhisë së parregullsive të pajisjeve me rrezatim jonizues, personeli punues i ekspozuar hapësirave me rrezatim jonizues duhet të bëjë kontroll specialistik mjekësor në afat edhe më të shkurtër.

Neni 10.

Përdorimin e pajisjeve instaluese me rrezatim jonizues e bëjnë vetëm personat fizik apo juridik të licencuar (Certifikuar) për kryerjen e aktiviteteve me pajisje të tilla.

Ndërrimi apo zëvendësimi i këtyre pajisjeve nga procesi tekniko teknologjik bëhet për mes institucioneve të specializuara dhe depozitohen – ruhen përkohësisht në Strehimoren (bunkerin) enkas të ndërtuar në ambientin e ish Gazifikimi.

Strehimorja duhet te jene çdo herë nën vëzhgim dhe me siguri fizike te plote 24 ore 7 dite ne jave. Ky objekt duhet te jete i rrethuar me tela (rrethoja) dhe te vendosen shenjat e rrezikut te dukshme ne perimetrin e rrethojës.

Neni 11.

Perimetri i Objektivit te Strehimores , dera dhe dryni mbahen ne gjendje te rregullt .

Incizimin eventual te depërtimit te rrezatimit duhet te kontrollohet ne mënyrë periodike nga institucioni i autorizuar.

Neni12.

Personeli gjatë punës operative të pajisjeve me rrezatim jonizues obligohet që të jenë të pajisur me PPM (pajisje personale mbrojtëse) nga rrezatimi radioaktiv (jonizues)

Neni 13.

Rregullorja hynë në fuqi nga dita e aprovimit të Bordit të Drejtorëve të KEK-ut.

Prishtinë

.....

Kryesuesi i Bordit te Drejtoreve/KEK

.....